VENDIM
Nr.46, datë 20.1.1997

PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR MATERIALET E PROMOCIONIT TURISTIK SHQIPTAR

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", neni 17 pika 3, me propozimin e Sekretarit të Shtetit për Turizmin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontraktimi dhe prodhimi i posterave dhe i materialeve të promocionit turistik të Shqipërisë të bëhet me prokurim të drejtpërdrejtë me:

a) firmën franceze "Michel Bernatets" për prodhimin e 7 llojeve të ndryshme posterash me pamje nga Shqipëria, me nga 1000 copë secila, në shumën totale 17,941 US $;

b) firmën gjermane "GRAF" për prodhimin e materialeve të tjera promocionuese me shumën totale prej 34,748 US $ e me sasirat respektive si më poshtë:

- Albania for Travellers 10 000 copë
- Albania-Investing in Tourism 5 000 copë
- Albania Tourist Information 10 000 copë
- 10 fletëpalosje të qyteteve të Shqipërisë me nga 4000 copë secila 40 000 copë.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për kontraktimin dhe prodhimin e materialeve të promocionit turistik me firmat e sipërpërmendura.

3. Shpenzimet për botimin e posterave dhe materialeve të promocionit turistik do të përballohen nga fondet e ndërmarrjes "Albturist" dhe nga të ardhurat dytësore të Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.603, datë 9.9.1996 "Për përdorimin e të ardhurave dytësore të Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi